



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORINA E PERGJITHSHME E THESARIT
DREJTORIA E THESARIT

Nr. 285 Prot.

Tirane, me 16/11/2006

U D H E Z I M

MBI
RAPORTIMIN E REALIZIMIT TE BUXHETIT TE SHETIT PER PERIUDHEN
01.01.2005-31.12.2005.

Ne mbeshtetje te nenit 102 te Kushtetutes, te nenit 53 te Ligjit Nr.8379, datë 29.07.1998 "Per hartimin dhe zbatimin e Buxhetit te Shtetit te Republikes se Shqiperise" dhe ne vijim te legjislacionit ekzistues per procedurat e sistemit te Thesarit, per pergatitjen dhe paraqitjen e raportit te realizimit te Buxhetit te Shtetit te vitit 2005, Ministria e Financave

Udhezon:

1. Per llogari te Buxhetit te Shtetit te vitit 2005, perfshihen ne raportin e vitit 2005 te gjitha transaksionet e kryera nga sistemi i Thesarit dhe Bankat deri me 31.12.2005. Bejne perjashtim rastet e autorizuara ndryshe nga Ministri i Financave deri me 15 Janar 2006.
2. Deget e Thesarit dhe **Deget e Bankave** rakordojne midis tyre brenda dates 18.01.2006.
3. Deget e **Tatimeve dhe Doganave** rakordojne me Deget e Thesarit brenda dates 20.01.2006.
4. Deget e Thesarit dorezojne **raportin** perfundimtar te te ardhurave e shpenzimeve ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit, te firmosur edhe nga Deget e Buxhetit brenda dates 24.01.2006.
5. **Njesite e Projekteve me Financime te Huaja, ISSH e ISKSH** dorezojne raportin perfundimtar te te ardhurave e shpenzimeve ne Drejtorine e

- Pergjithshme te Thesarit prane Ministrise se Financave, brenda dates 20.01.2006.
6. Drejtoria e Thesarit paraqet prane Drejtorise se Kontabilitetit ne daten 30.01.2006 raportin perfundimtar te te ardhurave dhe shpenzimeve te llogarise bankare "Depozite e Qeverise" .
 7. Drejtorise se Kontabilitetit ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit, dergon per konfirmim akt-rakordimin permbledhes ne Drejtorite Perkatese te Bankave te nivelit te dyte brenda dates 30.01.2006.
 8. Drejtorite e Bankave te nivelit te dyte konfirmojne te dhenat e derguara nga Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit brenda dates 05.02.2006.
 9. Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit pergatit e dergon per konfirmim akt-rakordimin perfundimtar per te ardhurat e shpenzimet e vitit 2005 ne Banken e Shqiperise brenda dates 05.02.2006.
 10. Banka e Shqiperise konfirmon te dhenat e Drejtorise se Pergjithshme te Thesarit brenda dates 10.02.2006.
 11. Drejtoria e Kontabilitetit ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit, pergatit **raportin fiskal** brenda dates 10.02.2006.
 12. Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit, Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve (per publikimin e shifrave ne faqen e internetit dhe per krijimin e fasiliteve) dergon per rakordim raportin vjetor te shpenzimeve per vitin 2005 ne cdo ministri dhe institucion qendror brenda dates 15.02.2006.
 13. Ministrite dhe institucionet qendrore brenda **20 diteve** nga marrja ne dorezim e raportit vjetor te shpenzimeve per vitin 2005 konfirmojne fillimisht ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit prane Ministrise se Financave, **mosperputhjet** me situacionet perfundimtare te institucioneve te tyre vartese te konfirmuara nga Deget e Thesarit. Pas kalimit te ketij afati, ne rast moskonfirmimi, merren te mireqena shifrat e raportuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit.
 14. Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit konfirmon perfundimisht brenda dates 30 Mars 2006 raportin fiskal te Buxhetit per vitin 2005.
 15. Projekt Ligji per miratimin e buxhetit faktik te Shtetit 2005 i shoqeruar me Raportin mbi ekzekutimin e buxhetit te Shtetit 2005, raportin mbi Fondin Rezerve dhe Raportin mbi Borxhin publik hartohet nga Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Pergjithshme e Makroekonomise dhe Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit dhe i paraqitet **Keshillit te Ministrave**

brenda dates 28 Prill 2006. Pas shqyrtimit dhe miratimit te tij i dergohet per miratim **Kuvendit** brenda dates 31 Maj 2006.

16. Drejtoria e Pergjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit, Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Teknologjise Informacionit ne Ministrine e Financave pergatisin Statistikat Financiare te Qeverise brenda dates 30.06.2006.

17. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

Ridvan BODE

MINISTER